

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.157/2013, “PËR MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen, sigurinë si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës. Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm synohet:

1. zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;
2. parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre;
3. zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave/financim terrorizmi.

Arritja e synimeve të mësipërme realizohet nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task-Force - FATF*), i cili përcakton standardet si dhe ndërmerr hapa për nxitjen dhe zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj përputhet me programin politik qeverisës 2017-2021 në angazhimet e shprehura në kuadër të “Sigurisë kombëtare dhe kontributit për sigurinë globale, “Pjesa IV - Politika e jashtme dhe e sigurisë, integrimi evropian dhe shqiptarët në botë”, ku parashikohet përmirësimi dhe modernizimi i mëtejshëm i menaxhimit të kufijve, rritja e kapaciteteve të bashkëpunimit e të shkëmbimit ndërkombëtar të të dhënave dhe informacionit do të kontribuojnë në

parandalimin dhe frenimin e qarkullimit ndërkufitar të krimit, terrorizmit, financave kriminale dhe migracionit të paligjshëm”.

Gjithashtu, hartimi i projektligjit është miratuar si detyrë dhe përparësi më 4.9.2018, nga Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave, i kryesuar nga Kryeministri dhe me anëtarë të gjitha organet relevante të fushës.

Projektligji është pjesë e programit analitik të projektakteve për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të Raundit të 5^{të} të Vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti *MONEYVAL* i Këshillit të Evropës¹, që është organi rajonal që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF-së. Në vlerësim identifikohen nevojat për ndryshim si dhe reflektohen rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike dhe efektivitetit me Rekomandimet e FATF-së.

Me këtë projektligj synohet përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6 i FATF, kriteret përkatëse të këtij rekomandimi si dhe rezultati imediat 10, elementë këta në tërësi të vlerësuar si pjesërisht të përmbushur. Vlen të evidentohet rëndësia e posaçme e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6, pasi është në grupin e atyre që konsiderohen kyçe në sistem parandalues dhe goditës ndaj terrorizmit dhe financimit të tij.

Në pasqyrim të gjetjeve të raportit për pjesën takuese e në funksion të rritjes së efektivitetit dhe përputhshmërisë të sistemit në parandalim të financimit të terrorizmit dhe zbatim në kohë dhe me efektivitet të masave të kërkuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB, janë përpiluar dhe amendamentet që përmban ky projektligj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji që propozohet për miratim do të ketë vendin e tij në rendin juridik shqiptar, i cili përcaktohet nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 116, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Baza ligjore për propozimin e këtij projektligji, sipas hierarkisë ligjore është përmbledhur në nenin 78, të

¹ Raporti i plotë gjendet në : <https://rm.coe.int/committe-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/16808ff138>

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 26, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe në pikën 3, të Rregullores së Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të ndryshuar.

Zbatimi i Rekomandimeve të FATF-së, të cilat përveçse janë botërisht të pranuar dhe ka mekanizma ndëshkimi në rastet e mos ndjekjes dhe zbatimit, për vendin tonë kanë forcë juridike të shtuar, pasi janë detyrim që rrjedh edhe nga neni 13 i Konventës së KiE, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646, datë 27.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës, “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Aktet e BE-së, që rregullojnë fushën e zbatimit të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit” janë, si më poshtë vijon:

- Rregullorja e Këshillit 2580/2001
- Qëndrimi i Përbashkët 2001/931/CFSP
- Rregullorja e Komunitetit Evropian 881/2002
- Rregullorja e Komunitetit Evropian 753/2011
- Rregullorja e Këshillit (BE) 2016/1686,

Qëllimi i këtij projektligji është përmbushja e detyrave të dala nga vlerësimi i Komitetit MONEYVAL, pra përafrimi me rekomandimin 6, të FATF-së dhe jo përafrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë me normativen e BE-së së sipërcituar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Referencat janë të lidhura me nenet në ligjin në fuqi. Ndryshimet e këtij projektligji konsistojnë, si më poshtë vijon.

1. Në nenin 3:

- në pikat 1 e 2, zgjerohet koncepti i bllokimit të përkohshëm në përputhje me kriteret e vendosura nga rekomandimet e FATF-së, për të siguruar që masat e marra në rast bllokimi/sekuestrimi përfshijnë edhe ndalimin e dhënies së shërbimeve financiare dhe se aplikohet ndaj të gjitha llojeve të pasurive;

- në fjalinë e parë të pikës 3, fjalët “... janë pasuritë financiare, depozitat monetare dhe pronat ...” zëvendësohet. Me këtë ndryshim synohet që fondet dhe pasuritë e tjera të përfshijnë, shprehimisht, burimet ekonomike, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.5, shkronja “b”).

2. Në nenin 6:

në pikën 4, pas fjalisë së parë shtohen “Të njëjtat masa merren edhe për fondet dhe pasuritë e tjera,:

- a) në të cilat personi i shpallur ushtron të drejta kontrolli faktike;
- b) që zotërohen apo kontrollohen nga personi i shpallur, duke mos i kufizuar masat për fondet dhe pasuritë e tjera që mund të lidhen me një akt terrorist specifik, komplot apo kërcënim;
- c) që janë individualisht apo bashkërisht të zotëruara apo kontrolluara, direkt apo indirekt, nga persona të shpallur;
- ç) të rrjedhura apo prodhuara nga fondet ose pasuritë e zotëruara apo të kontrolluara, direkt apo indirekt nga personat e shpallur;
- d) të personave që veprojnë për llogari apo nën drejtimin e personave të shpallur.”, përmbajtja e së cilës synon që detyrimi për bllokim të përfshijë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe elemente të tjera të fondeve apo pasurive të tjera, të zotëruara apo kontrolluara në mënyrë indirekte apo në dispozicion të personave të shpallur, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së.

3. Në nenin 10:

- në pikën 1, pas fjalëve “... janë të detyruara të raportojnë menjëherë ...”, shtohen “..., pa njoftim paraprak të personave të dyshuar,...”; në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.5). Me këtë shtesë synohet që fondet dhe asetet e personave apo enteve të shpallura të bllokohen pa njoftim paraprak;
- në pikën 2, fjalët “... është i detyruar të njoftojë menjëherë organet e zbatimit të ligjit ose Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave...” zëvendësohen me “... është i detyruar që, pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar apo të prekur, të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.” me synim garantimin e mekanizmit të bllokimit të fondeve dhe pasurive të tjera, duke e kaluar njoftimin në një autoritet të vetëm, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.5, shkronja “a”).

4. Pas nenit 10 shtohet neni 10/1, për të garantuar zbatimin pa vonesë (që tanimë interpretohet si çështje orësh dhe që duhet të gjejë zbatim

menjëherë) të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në lidhje me terrorizmit dhe/ose financimin e tij, element ky që është vlerësuar ende problematik nga Komiteti Moneyval.

5. Në neni 14:

- shkurtohen afatet e zbatimit të rezolutave;
- saktësohet detyrimi për nxjerrje urdhri bllokimi nga ministri përgjegjës për financat, nëse ka të dhëna për ekzistencën e tyre brenda vendit;
- shtohet një pikë, që synon saktësim të procedurave dhe standardeve që do të ndiqen, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.5, shkronja “b”).

6. Në nenin 15 zgjerohet koncepti i përfshirjes së personave të dyshuar si dhe shtohet pika 1/1, që synon sqarim procedure dhe lidhje me pikën 2, të nenit 5, të ligjit.

7. Në nenin 16:

- pika 1 ndryshohet, duke hequr diskrecionin për nxjerrjen e urdhrit nga ministri i ngarkuar, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.4);
- pika 2 ndryshohet, duke shtuar afatin e urdhrit të bllokimit, me synim që të paraprihet çdo lloj problematike apo shtate sipas të cilës vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave nuk miratohet në kohë, duke rrezikuar lirin e fondeve të bllokuara.

8. Në nenin 18 ndryshohet pika 4, me synim që:

- afatet për njoftim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të jenë të njëjta, sipas kërkesave të rezolutave të komiteteve përkatëse;
- të ndiqen procedurat dhe formularët standarde, siç janë miratuar nga Komitetet përkatëse, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF (kriteri 6.1 shkronja “d”);
- të sigurohet sa më shumë që të jetë e mundur informacioni identifikues dhe informacioni të posaçëm që mbështet shpalljen, kur i kërkohet një vendi tjetër njohja e masave të nisura nën mekanizmin e bllokimit, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.2, shkronja “e”)

9. Në nenin 21 ndryshohen pikat 2 dhe 3, duke shkruar afatet e verifikimeve, nisur nga konstatimi për veprime jo në kohë, për implementim të sanksioneve, të evidentuara në Raportin e Moneyval.

10. Në nenin 23, shtohet pika 3/1, duke saktësuar procedurën e lejimit të shpenzimeve, sipas këtij neni.

11. Në nenin 25:

- në pikën 1, fjalët fjalët “... ose mbështetur në kërkesën e personit të shpallur,” zëvendësohen me “... kërkesën e personit të shpallur ose të personit të cenuar gabimisht,”;
- pas shkronjës “dh”, të pikës 4, shtohet shkronja “e”, “e) për shkak të kërkesës së bazuar të personave të prekur gabimisht nga masat e parashikuara në këtë ligj;”, që synojnë parashikimin e procedurave për zhbllokimin e fondeve të personave të cenuar gabimisht², në përputhje me rekomandimin 6 të FATF (kriteri 6.6 shkronja “f”);
- pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2. Ndryshimet synojnë vendosjen e procedurave për paraqitjen pranë komiteteve përkatës të OKB-së, të kërkesave për heqje nga lista të personave apo enteve të shpallur, sipas regjimit të sanksioneve të OKB-së, të cilët, sipas vlerësimit të vendit nuk plotësojnë kriteret për shpallje, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.6, shkronja “a”);
- në pikën 5, shkurtohet afati për kthimin e pasurive të sekuestruara, në përputhje me rekomandimin 6.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTLIGJI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen kryesisht institucionet, subjektet dhe personat e përcaktuar në nenet 7, 8, 9 dhe 10 të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT.

Projektligji është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Nga DPPPP-ja është kërkuar asistencë e Këshillit të Evropës, në kuadër të projektit “Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri (AEC-AL)”, për kontraktimin e një eksperti të jashtëm të pavarur, për të dhënë opinion ligjor në lidhje me ndryshimet e propozuara, proces i cili është realizuar.

² Kriteri 6.6 germa “f” e Rekomandimit 6 të FATF

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE